



Republika Kosova - Republika e Kosovës, Republic of Kosovo
Opština Strpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

Në bazë të nenit 11, 12, 24 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 40 të Ligjit nr. 2004/18, për tregtinë e brendshme, Udhëzimit administrativ nr. 2007/03, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizmit të tregtisë, si dhe neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 09.08.2023 miratoi këtë :

RREGULLORE PER

NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORES NR.01-16-928 TE DATES 04.04.2012 PËR
FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN
E SHTERPCES

Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Per Fillimin dhe Mbarimin e Orarit te Punës te Organizatave te Biznesit ne Komunën e Shtërpçës Nr.01-16-928 te datës 04.04.2012

Neni 2.

Neni 18 i rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

“18

Inspektimi

1. Autorizimet e Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Shtërpçës inspektorit për respektimin e orarit të punës

1.1 Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori është i autorizuar:

- Të konstatojë shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje;
- Të urdhëroj ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e shkeljes së konstatuar;
- Të urdhëroj subjektin afarist, përkatësisht personin e autorizuar të të njëjtit, që të respektojë orarin e punës të përcaktuar me këtë rregullore;
- Të ndërmarr të gjitha masat ndëshkuese dhe të shqiptojë gjobë për mosrespektim të orarit të punës në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.”
- e)

Neni 3

Te gjitha dispozitat tjera te Rregullores bazike mbeten te pa ndryshuara.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MPL-së dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës

